



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

AA.nr.123/2025

GJYKATA SUPREME E KOSOVËS, në kolegjin e përbërë nga gjyqtarët Mr.sc. Muhamet Rexha, kryetar i kolegjit, Franciska Zhitija – Ymeri dhe Faton Bajrami, anëtar të kolegjit, në çështjen juridike, për shkak të zgjedhjes së anëtarit prokuror të Këshillit Prokurorial të Kosovës, duke vendosur sipas ankesës së Merita Kurtishi Gaka Prokurore e Shtetit në Prokurorinë Themelore në Prishtinë, paraqitur kundër vendimit të Këshillit Prokurorial të Kosovës, KPK/Nr. 1037/2025, të datës 13 nëntor 2025, në seancën të kolegjit të mbajtur me datë 8.12.2025, merr këtë:

A K T V E N D I M

HEDHET si e palejuar ankesa e Merita Kurtishi Gaka, Prokurore në Prokurorinë Themelore në Prishtinë, e paraqitur kundër vendimit të Këshillit Prokurorial të Kosovës Prishtinë, KPK. nr.1037/2025 i datës 13 nëntor 2025.

A r s y e t i m

Me pikën 1. të dispozitivit të vendimit të Këshillit Prokurorial të Kosovës KPK/Nr.1037/2025 dt.13 nëntor 2025, refuzohet ankesa e paraqitur nga Prokurorja e Shtetit Merita

Kurtishi Gaka, kundër njoftimit të Komisionit Zgjedhor të Këshillit Prokurorial të Kosovës. Me pikën 2. të dispozitivit të këtij vendimi obligohet Sekretariati që këtë vendim ta publikojë brenda 15 ditëve në faqen zyrtare të Këshillit Prokurorial të Kosovës, dhe me pikën 3. të dispozitivit të tij, vendimi hyn në fuqi ditën e miratimit nga Këshilli Prokurorial i Kosovës.

Kundër vendimit të sipër përmendur të Këshillit Prokurorial të Kosovës, ka paraqitur ankesë Merita Kurtishi Gaka, Prokurore në Prokurorinë Themelore në Prishtinë, për shkak të shkeljes esenciale të dispozitave të Ligjit për Konfliktet administrative, vërtetimit të gabuar apo jo të plotë të gjendjes faktike dhe zbatimit të gabuar të së drejtës materiale, me propozim që të merret aktgjykim me të cilin aprovohet ankesa, të anulohet vendimi i Këshillit Prokurorial të Kosovës me nr.KPK.1037/2025 dt.13 nëntor 2025, si vendim i kundërligjshëm, të anulohet njoftimi i KPK-së me nr. KZ-KPK dt.1.11.2025, dhe të detyrohet i padituri Këshilli Prokurorial i Kosovës, me seli në Prishtinë, që të anulojë tërësisht procesin e zhvilluar të zgjedhjeve dhe zgjedhjen e kandidatit të shpallur fitues, si dhe të rishpallë dhe organizojë një proces të ri zgjedhor, në pajtim të plotë me ligjin, brenda afatit prej 15 ditësh nga dita kur ky aktgjykim merr formë të prerë.

Përgjigje në ankesë ka paraqitur Këshilli Prokurorial i Kosovës, nëpërmjet të cilës kundërshton pretendimet ankimore, me propozim që e njëjta të refuzohet si e pa themeltë.

Gjykata Supreme e Kosovës, pas shqyrtimit të shkresave të lëndës dhe vlerësimit të lejueshmërisë së ankesës, ka gjetur se:

Ankesa e paraqitur nga Merita Kurtishi Gaka, Prokurore në Prokurorinë Themelore në Prishtinë, është e pa lejuar.

Gjykata Supreme Kosovës, ka bërë vlerësimin e lejueshmërisë së ankesës në kuptim të dispozitës së nenit 8 të Ligjit Nr.08/L-249 Për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit Nr.06/L-056 Për Këshillin Prokurorial të Kosovës, me të cilën është përcaktuar se “ Pas nenit 10 të ligjit bazik, shtohen nenet 10/A dhe 10/B me tekstin si në vijim” të nenit 10/A dhe nenit 10/B, dhe sipas dispozitave përkatëse të nenit 10/A, ka gjetur se ankesa është e palejuar, ndaj, ka vendosur që të njëjtën t’u hedhë si të palejuar. Ndryshimet e sipër përmendura janë, pra, lidhur me kapitullin II të Ligjit bazik Për Këshillin Prokurorial të Kosovës, që kanë të bëjnë me “Detyrat, Përgjegjësitë dhe Përbërja e Këshillit”, përkatësisht, me “ Zgjedhjen e anëtarëve prokurorë” në KPK. Kështu, veç tjerash, me dispozitat e nenit 10/A të Ligjit të sipër përmendur, si paragrafët 12, 13,14, 15, të këtij neni, përcaktohet që “ Organizimi i votimit bëhet në konferencën e përgjithshme të të gjithë prokurorëve të shtetit ...; Votimi është i fshehtë; Prokurori që merr më së shumti vota për pozitën në të cilën kandidon, fiton të drejtën për t’u zgjedhur...;

Pas përfundimit të procesit zgjedhor, Komisioni Zgjedhor paraqet raport për Këshillin lidhur me kandidatët dhe numrin e votave për secilin kandidatë dhe informon kandidatët për rezultatin e zgjedhjeve dhe të drejtën e ankesës për procesin. Kandidatët kanë të drejtë të paraqesin ankesë për shkeljet procedurale, në afatin prej 72 orëve pranë Këshillit, pas njoftimit me rezultatin...; Pas shqyrtimit të ankesave, Këshilli brenda 7 ditëve shpall dhe certifikon rezultatet përfundimtare të procesit zgjedhor..., etj”, ndërsa, sikundër rrjedh nga shkresat e lëndës, kështu edhe ka ndodhur në rastin konkret.

Prandaj, Gjykata Supreme e Kosovës, ka gjetur se nga interpretimi i dispozitave të sipër përmendura ligjore, rezulton se ankesa në rastin konkret, në Gjykatën Supreme të Kosovës, është e palejuar. Ndërkohë që, për sa i përket çështjes së nenit 18 të Ligjit për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit për Këshillin Prokurorial të Kosovës, të sipër cekur, se pas nenit 23 të Ligjit Bazik, shtohet neni 23/A , rreth çështjes “ E drejta në ankesë”, kjo Gjykatë, vlerëson se i njëjti lidhet me kapitullin e III të Ligjit Bazik, e që ka të bëjë me Rekrutimin, Propozimin dhe Emërimin e Prokurorëve në nivelet përkatëse të Prokurorisë së Shtetit, e jo me çështjen nga Kapitulli II i Ligjit të sipër përmendur. Kështu, në kontekstin e mësipërm duhet theksuar se, “ Një anëtarë i Këshillit i cili është shkarkuar gëzon të drejtën të ankohet kundër vendimit të Këshillit drejtëpërsëdrejti në Gjykatën Supreme të Kosovës, brenda 15 ditëve nga vendimi për shkarkim, përkatësisht, “

Prokurorët kanë të drejtë të ankohen ndaj vendimit mbi shkarkimin drejtëpërdrejtë në Gjykatën Supreme të Kosovës “ (dispozitat e nenit 19 par.4 dhe nenit 25 par.2 të Ligjit për Këshillin Prokurorial të Kosovës), ndërsa, këtu në rastin konkret, në kuptim të asaj që u sipër theksua, u mor vesh, nuk kemi të bëjmë as me emërim, as me shkarkim të prokurorit dhe as me shkarkim të një anëtari të Këshillit Prokurorial.

Prandaj, nga këtu, dhe nga arsyet e sipër përmendura, si dhe në mbështetje të dispozitave të sipër përmendura ligjore, Gjykata Supreme e Kosovës, vendosi si në diapozitiv të këtij aktvendimi.

GJYKATA SUPREME KOSOVËS-PRISHTINË

AA.nr.123/2025 dt. 8.12.2025

Kryetari kolegjit,

Mr.Sc.Muhamet Rexha

